



BULETIN



RRITJA E PJESËMARRJES SË PUBLIKUT NË PROCESIN LEGJISLATIV

Buletin dyjavor / Nr.7

Qershor 2004

Projekt i Qendrës së Studimeve Parlamentare dhe Programit të Drejtësisë, Fondacioni Shoqëria e Hapur (SOROS)

Nga Mbledhjet e Këshillit të Ministrave

I. Mbledhja e Këshillit të Ministrave e datës 1.6.2004.

PROJEKTLIGJE

Vendime të Këshillit të Ministrave për propozim projektligji Kuvendit.

1. "Për masat kundër financimit të terrorizmit"

Në këtë projektligj përcaktohen masat kundër financimit të terrorizmit si dhe procedurat e kontrollit për zbatimin e tyre. Në këtë prizëm, projektligji parashikon parandalimin e veprimtarive dhe goditjen e subjekteve terroriste dhe atyre që mbështesin e financojnë terrorizmin, duke bllokuar dhe sekuestruar fondet e pasuritë e tyre, sipas rezolutave përkatëse të Këshillit të Sigurimit të OKB-së, si dhe në raste të tjera të parashikuara në këtë ligj.

2. "Për disa ndryshime në ligjin nr. 9165, datë 23.12.2003, "Për buxhetin e shtetit të vitit 2004."

Pas diskutimit në mbledhjen e Komitetit të Politikave Ekonomike, u përgatit ky Projekt i buxhetit suplementar, bazuar në burimet suplementare të siguruara nga privatizimi i Bankës së Kursimeve.

Të ardhurat e siguruara janë parashikuar të përdoren në masën 50% për reduktimin e huamarrjes së brendëshme dhe pjesa tjetër për investime.

(Vijon në faqen 2)

Ftesë e Hapur për Bashkëpunim

Ministria e Ekonomisë në mbështetje të:

Ligjit Nr. 8810, datë 17.05.2001 "Për përcaktimin e formës dhe të strukturës së formulës së privatizimit të shoqërisë anonime "Albtelecom";

Ligjit Nr.9127, datë 29.07.2003 "Për disa shtesa në ligjin nr.8810 datë 17.05.2001 "Për përcaktimin e formës dhe strukturës së formulës së privatizimit të shoqërisë anonime "Albtelecom";

Ligjit Nr.9117, datë 24.07.2003, "Për përcaktimin e formës dhe strukturës së formulës së privatizimit të shoqërisë anonime "Armo Fier";

dhe të programit të punës së Qeverisë Shqiptare ka përgatitur draftin e paketës së akteve nënligjore për privatizimin e dy shoqërive të rëndësishme që funksionojnë në sektorët strategjikë të ekonomisë shqiptare,

(Vijon në faqen 8)

Në këtë numër do të lexoni:

1. Nga Mbledhjet e Këshillit të Ministrave
faqe 1-3

2. Informacion mbi faqet e internetit të Institucioneve Qendrore
faqe 1

3. Ftesë e Hapur për Bashkëpunim
faqe 1 dhe 8

4. Nga punimet e Kuvendit për periudhën 1-15 qershor 2004
faqe 4-5

5. Kalendari 2 javor i Kuvendit, 21 qershor - 1 korrik 2004
faqe 6-7

Informacion mbi faqet e internetit të Institucioneve Qendrore

Kuvendi i Shqipërisë
www.parlament.al

Këshilli i Ministrave
www.keshilliministrave.al

Presidenca
www.president.al

Bashkia e Tiranës
www.tirana.gov.al

Ministria e Arsimit dhe e Shkencës
www.mash.gov.al

Ministria e Punëve të Jashtme
www.mfa.gov.al

Ministria e Shëndetësisë
www.moh.gov.al

Ministria e Rendit Publik
www.mpo.gov.al

Ministria e Pushtetit Vendor dhe Decentralizimit
www.mpvd.gov.al

Ministria e Transportit dhe Telekomunikacionit
www.mtt.gov.al

Nga Mbledhjet e Këshillit të Ministrave

(Vijon nga faqja 1)

VENDIME të Këshillit të Ministrave.

1. "Për miratimin e dokumentit "Analiza e realizimit për vitin 2003, Vizioni dhe Objektivat afatgjata të Strategjisë Kombëtare të Zhvillimit Ekonomiko – Social (SKZHES)".

2. "Për miratimin e mandatit të procedurave të auditimit të brendshëm, të kodit etik për auditet e brendshme dhe të kartës së auditimit të brendshëm publik".

3. "Për disa ndryshime e shtesa në vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 335, datë 23.06.2000 "Për rregullat e prokurimit".

Ndryshimet kryesore ndër të tjera konsistojnë në:

-Procedurat e prokurimit për shërbimet e prokurimit duke marë si bazë për vlerën e objektit, si vlera e objektit të ndërtimit ashtu edhe ajo e shërbimit.

-Të lejohet si garanci bankare edhe garancia e lëshuar nga Agjensitë e sigurimeve të licensuara nga shteti.

-Përcaktimi i afateve kohore për lidhjen e kontratave.

4. Për disa shtesa e ndryshime në Vendimin e Këshillit të Ministrave nr 675, datë 20.12.2002 "Për përdorimin e fondeve buxhetore të planifikuara për mallrat shërbimet dhe ndërtimet."

Ndryshimet e propozuara janë rrjedhojë e problemeve të hasura nga zbatimi në praktikë i VKM.

Në fuqi dhe kanë si qëllim përmirësimin e sistemit të prokurimit në shkallë vendi.

5. Për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin nr.726, datë 21.12.2000 të Këshillit të Ministrave "Për pagat e punonjësve të institucioneve buxhetore" i ndryshuar.

6. Për përcaktimin e koeficientëve të shtesës së bazës së vlerësimit vjetor, individual, për llogaritjen fillestare të pensioneve".

-vendimi përcakton koeficientët e shtesës së bazës së vlerësuar individuale që personat kanë arritur nëpërmjet kontributeve të derdhura për llogari të Fondit të Sigurimeve Shoqërore.

7. Për miratimin e disa shtesave e ndryshimeve në rregulloren e personelit të Policisë së Shtetit.

-Ndryshimet synojnë t'u japin zgjidhje një sërë problemesh që kanë dalë nga zbatimi praktik i kësaj

rregulloreje gjatë 4 vjetëve.

8. Për fillimin e negociimit për dhënie me koncesion të zonës së Porto-Romanos-Durrës, dhe për disa ndryshime në vendimin e Këshillit të Ministrave nr.30, datë 21.01.2002 "Për kriteret e zgjedhjes dhe rregullimin e marrëdhënieve të shoqërive që do të ndërtojnë dhe përdorin instalime bregdetare, për transportimin dhe depozitimin e naftës, gazit dhe nënprodukteve të tyre."

Vendimi synon t'i japë zgjidhje plotësimi të infrastrukturës portuale të zonës së Porto-Romanos.

9. Për heqjen nga lista e sektorëve strategjikë dhe kalimin në privatizim e mbyllje të fabrikës së pasurimit të kromit në Kalimash në Qarkun e Kukësit.

10. Për një shtesë në Vendimin e Këshillit të Ministrave nr.378, datë 12.8.1999 "Për kalimin e së drejtës së përfaqësuesit të pronarit për disa objekte, pronë publike, organeve të qeverisjes vendore.

-Vendimi synon t'u përgjigjet kërkesave të organeve të qeverisjes vendore për ambiente publike dhe strehimi për shtresat sociale në nevojë.

11. Për ndryshime në strukturën dhe pagat e punonjësve të Policisë së Ndërtimit.

12. Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajteshme shtetërore, të cilat i kalojnë në përgjegjësi administrimi Ministrisë së Industrisë dhe Energjitikës.

13. Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajteshme shtetërore, të cilat i kalojnë në përgjegjësi administrimi ALBKROM-sh.a.

14. Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajteshme shtetërore, të cilat i kalojnë në përgjegjësi administrimi ALB-BAKËR-sh.a.

15. Për ndryshimin e përgjegjësisë së administrimit të mjediseve të repartit ushtarak nr.1023 në qytetin e Vlorës, të cilat janë në përgjegjësi administrimi të Ministrisë së Mbrojtjes dhe për një ndryshim në Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 515, datë 18.2003 "Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajteshme shtetërore, të cilat i kalojnë në përgjegjësi administrimi Ministrisë së Mbrojtjes".

16. Për lejimin e Ministrisë së Mbrojtjes të përdorë procedurën "Prokurim i drejtëpërdrejtë", për sigurimin e jetës së ushtarakëve me misionë jashtë shtetit dhe në raste aksidentesh në grup.

17. Për miratimin në parim të marrëveshjes mbi shërbimet ajrore, ndërmjet Këshillit të Ministrave të republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Serbisë dhe Malit të Zi.

18. Për miratimin në parim të marrëveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave të republikës së Shqipërisë dhe Shoqatës Ndërkombëtarepër zhvillim (IDA) për administrimin nga kjo shoqatë, të fondeve të grantit japonez, për përgatitjen e projektit të zhvillimit të burimeve natyrore të Shqipërisë.

19. Për sistemimin me mjedise pune të disa institucioneve shtetërore.

20. Për një ndryshim në Vendimin e Këshillit të Ministrave nr.590, datë 22.12.1997 "Për caktimin e dy anëtarëve në Këshillin Administrativ të Institutit të Sigurimeve të Kujdesit Shëndetësor", të ndryshuar.

-Informacion mbi zbatimin e planit të veprimit të strategjisë kombëtare të fëmijëve. (Përgatitur nga raportimet e ministrive dhe institucioneve të ngarkuara me detyra në Planin e Veprimit për zbatimin e Strategjisë Kombëtare për Fëmijët)

II. Mbledhja e Këshillit të Ministrave e datës 11.6.2004.

PROJEKTLIGJE

Vendime të Këshillit të Ministrave për propozim projektligji Kuvendit të Republikës së Shqipërisë.

1. "Për miratimin e strategjisë së sigurisë së Republikës së Shqipërisë".

Ky ligj synon që duke u bazuar në angazhimet qeverisëse vëndase dhe ndërkombëtare, të fokusojë një kuadër të plotë strategjik të sigurisë në vend, i ndërthurur ky me elementët e nevojshëm të fuqisë kombëtare.

2. "Për disa ndryshime në ligjin, "Për dërgimin e një force ushtarake shqiptare në Afganistan, në kuadër e Koalicionit Ndërkombëtar Kundër Terrorizmit".

Sipas projektligjit parashikohet vetëm ndryshimi i njësisë ushtarake. Pra nuk do të ketë shtesë në

(Vijon në faqen 3)

Nga Mbledhjet e Këshillit të Ministrave

(Vijon nga faqja 2)

numrin e trupave ushtarake në misionin në Afganistan.

Kontigjenti i vetëm ka qenë një Batalion i Operacioneve Speciale, e me ndryshimin e ligjit, parashikohet të jetë nga Brigada e Reagimit të Shpejtë.

3. "Për ratifikimin e Protokollit nr.2 të Konventës Për të Drejtat e Njeriut dhe Lirive Themelore".

Ratifikimi i këtij Protokollit është në kuadrin e përjasjes së legjislacionit shqiptar me atë europian dhe një hap në drejtim të bashkëpunimit ndërkombëtar në mbrojtjen e parimeve themelore të të Drejtave të Njeriut. Parimi themelor i Protokollit është parimi i barazisë përpara ligjit dhe mosdiskriminimit për cilindo për shkaqe si: raca, seksi, ngjyra, gjuha, feja, pikpamjet politike, origjina kombëtare ose shoqërore, pasuria etj.

4. "Për ratifikimin e Konventës Europiane, "Për Kompensimin e Viktimeve të Krimeve të Dhunshme".

Konventa parashikon parimet kryesore mbi të cilat palët do të kompensojnë viktimat e krimit të dhunshëm si dhe detyrimin për të parashikuar në legjislacionin e brendshëm masat ligjore përkatëse në bazë dhe për zbatimin e Konventës.

5. "Për ratifikimin e Protokollit shtetësë mbi krimin hibernetik, "Për penalizimin e akteve me natyrë sadiste dhe ksenofobike, të kryera nëpërmjet sistemeve kompjuterike".

Konventa "Për Krimin në Fushën e Hibernetikës" është ratifikuar nga Republika e Shqipërisë në prill të vitit 2002. Në plotësim të kuadrit rregullator të Konventës shtetet antarë të KE dhe shtetet e tjera palë të saj, kanë hartuar Protokollin Shtetësë "Mbi penalizimin e akteve me natyrë sadiste dhe ksenofobike, të kryera nëpërmjet sistemeve kompjuterike".

6. "Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në Konventën, "Për ratifikimin e disa rregullave për transportin ajror ndërkombëtar".

Aderimi në këtë Konventë do të plotësojë kuadrin ligjor të transportit ajror në përputhje me standardet ndërkombëtare të aviacionit civil.

7. "Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në Konventën e Kombeve të Bashkuara "Për Kushtet e regjistrimit të anijeve (Gjenevë 7 shkurt

1986)". Projektligji i shërben procesit integruar të vendit edhe nëpërmjet anëtarësimit dhe bërjes palë në këto instrumenta, si dhe sjell unifikim dhe përjasje të infrastrukturës ligjore dhe nënligjore të lundrimit.

8. "Për ratifikimin e marrëveshjes së Grandit ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe BERZH për projektin e menaxhimit të integruar të ekosistemit".

9. "Për ratifikimin e marrëveshjes së kredisë së Zhvillimit ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Shoqatës Ndërkombëtare për Zhvillim (IDA) për projektin e Prodhimit dhe Ristrukturimit të sektorit të energjisë".

10. "Për ratifikimin e Konventës së Stokholmit, "Për Ndotësit Organikë të Qëndrueshëm".

VENDIME të Këshillit të Ministrave

1. Për krijimin e mënyrën e mbajtjes së Regjistrimit të Gjendjes Civile dhe rregullat e shfrytëzimit të teknikës dhe mjetit informatik".

Sipas vendimit të lartpërmendur Regjistri Kombëtar do të vendoset në ambjentet e Drejtorisë së Përgjithme të Gjendjes Civile dhe do të mbahet në dy kopje. Një kopje do të ruhet si objekt i rëndësishëm të veçantë, për të ndaluar ndërhyrjet e paligjshme si dhe mbrojtjen nga agjentët natyrorë.

2. "Për miratimin e Listës së Inventarit të Pronave të Paluajtshme Shtetërore të Shërbimit Gjeologjik Shqiptar, të cilat i kalojnë në përgjegjësi administrimi Ministrisë së Industrisë dhe Energjitikës".

3. "Për miratimin e Listës së Inventarit të Pronave të Paluajtshme Shtetërore, të cilat i kalojnë në përgjegjësi administrimi "Posta Shqiptare" sha-së".

4. "Për miratimin e Listës së Inventarit të një depoje të Drejtorisë së Përgjithshme të Rezervave Shtetërore në Lundër dhe kalimin e saj në përgjegjësi administrimi të KQZ-së (Komisionit Qëndror të Zgjedhjeve)".

5. "Për një ndryshim e shtesë në vendimin e Këshillit të Ministrave nr.241, datë 18.05.2000 "Për riorganizimin dhe funksionimin e komisionit të çmimeve të barnave". Ndryshimet dhe shtesat konsistojnë në riorganizimin e komisionit të

çmimeve dhe barnave dhe konkretisht:

a.Ministria e Shëndetësisë përfaqësohet me tre antarë, ndërmjet tyre edhe kryetari.

b.Përfshihet në komision Shoqata e Grosistëve.

c.Me krijimin e Urdhërit të Farmacistëve, Urdhri i mjekut zëvendësohet me përfaqësuesin e Urdhërit të Farmacistëve.

6. Për lejimin e Ministrisë së Transportit dhe Telekomunikacionit të përdorë procedurën "Prokurim i drejtëpërdrejtë" për vlerësimin e studimit të fizibilitetit për modernizimin e linjës hekurudhore Tiranë-Durrës" dhe të linjës hekurudhore me aeroportin "Nënë Tereza" Rinas.

7. "Për miratimin në parim të Protokollit ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës Popullore të Kinës, për dhënien e një ndihme falas në formën e materialeve dhe pajisjeve". Në Protokoll parashikohet dhënia e një ndihme falas prej 15 milion Yuan RMB, për të importuar nga Kina materiale, makineri dhe pajisje për përmirësimin e infrastrukturës së ujësjellës-kanalizimeve, si dhe për policinë e ndërtimit.

8. "Për miratimin në parim të Marrëveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës së Austrisë, për asistencën e ndërsjelltë dhe bashkëpunim në çështjet doganore".

9. "Për miratimin në parim të Marrëveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës së Maqedonisë për mbrojtjen dhe zhvillimin e qëndrueshëm të Liqenit të Ohrit dhe pellgut të tij ujëmbledhës".

10. "Për miratimin në parim të Memorandumit të Mirëkuptimit në fushën e mbrojtjes së mjedisit, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës së Kroacisë".

11. "Për shpërbllimin e antarëve të këshillave të baseneve ujëmbledhës dhe të këshillave konsultativ teknik, pranë autoritetit të ujit".

12. "Për miratimin në parim të marrëveshjes, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës së Turqisë, për sigurimin e uniformave ushtarake dhe të aksesoreve të saj, për nevojat e Forcave të Armatosura të Shqipërisë".

NGA PUNIMET E KUVENDIT PËR PERIUDHËN 1-15 QERSHOR 2004

1. P/ligji “Për njohjen, kthimin dhe kompensimin e pronës”

Në seancat plenare të periudhës 27 maj-8 qershor 2004 Kuvendi vazhdoi me shqyrtimin e projektligjit nen për nen, duke u apërqendruar në shqyrtimin e amendamenteve të paraqitura nga disa deputetë ose grupe deputetësh për nene të caktuara të tij. Disa nga amendamentet kryesore që u debatuan ishin:

- Amendamentet për nenin 9 të projektligjit, i cili bën fjalë për banesat që janë pronë e subjekteve të shpronësuara dhe që aktualisht janë të zëna nga qiramarrës që paguajnë qira të ulëta. Sipas projektligjit, “brenda dy vjetësh nga hyrja në fuqi e këtij ligji, shteti duhet t’u sigurojë qiramarrësve që banojnë në banesat pronë e subjekteve të shpronësuara, një banesë me sipërfaqe të njëjtë me atë që jetojnë ose t’u sigurojë kredi me interesa të ulëta. Me kalimin e periudhës dyvjeçare, shteti paguan vlerën e qirasë në emër të qiramarrësve tek subjektet e shpronësuara sipas çmimit të tregut.”

Në njerin prej amendamenteve propozohet zgjatja e afatit të qëndrimit të qiramarrësve në banesat pronë e subjekteve të shpronësuara nga 2 në 3 vjet. Ndryshimi kryesor i këtij amendamenti nga neni i projektligjit është që shteti të mos vihet para detyrimit që t’u sigurojë qiramarrësve banesë brenda dy vjetëve, por ai të jetë i detyruar t’u sigurojë qiramarrësve vetëm kredi me terma të buta, ku shteti paguan interesin. Amendamenti gjithashtu propozon ndryshimin e afatit brenda të cilit qiramarrësi paguan qira me çmimet e tregut sipas vendimit të Këshillit të Ministrave, i cili nga dy vjet, propozohet të bëhet deri në fund të vitit 2004. Pas kësaj date, deri në strehimin e qiramarrësve mbi bazën e kredisë së marrë, por jo më shumë se një vit pas marrjes së saj, vlerën e qirasë sipas vlerës së tregut në emër të qiramarrësve e paguan shteti.

Amendamenti tjetër propozon vënien e Këshillit të Ministrave para detyrimit që të sigurojë strehimin e qiramarrësve nëpërmjet banesave me qira të ulët, kredive me interes të ulët ose banesave me qira të kompensuar nga shteti. Gjithashtu, ky amendament i detyron qiramarrësit të lirojnë banesat pronë e subjekteve të shpronësuara brenda një afati tre vjeçar.

Pas diskutimit të amendamenteve të mësipërme për riformulimin e nenit 9 të projektligjit, Kuvendi miratoi amendamentin e dytë, duke shtuar edhe saktësimin që qiramarrësit që përfitojnë nga ky nen duhet të jenë të pajisur me statusin e të pastrehit.

- Kuvendi diskutoi edhe amendamentet e paraqitura për shtesën e një pike në nenin 9 të projektligjit, e cila të parashikojë zgjidhje për rastet e banesave të ndërtuara në kundërshtim me legjislacionin në fuqi. Komisioni i Përhershëm i Ekonomisë, Financave dhe Privatizimit propozoi që banorët e këtyre banesave të kenë të drejtën e blerjes së truallit pas procesit të legalizimit, të përcaktuar me ligj të veçantë, ndërsa vlerësimi i truallit të bëhet sipas vlerës së tregut në momentin e kryerjes së legalizimit të

banesave. Komisioni i Përhershëm i Çështjeve Kushtetuese dhe Ligjore propozoi që ndërtimet e banesave në kundërshtim me legjislacionin në fuqi të rregullohen me ligj të veçantë. Në përfundim, Kuvendi miratoi propozimin e Komisionit të Ekonomisë, Financave dhe Privatizimit për këtë çështje. - Amendamentet e paraqitura nga disa deputetë për nenin 15, pika 1 të projektligjit, i cili bën fjalë për përbërjen e Komitetit Shtetëror për Kthimin dhe Kompensimin e Pronave. Sipas projektligjit, ky Komitet përbëhet nga pesë anëtarë, të cilët emërohen nga Kuvendi. Një anëtar propozohet nga Presidenti i Republikës, dy anëtarë propozohen nga pozita dhe dy anëtarë nga opozita parlamentare. Anëtari i propozuar nga Presidenti është Kryetar i Komitetit.

Në amendamentin e deputetëve të Partisë Socialiste propozohet që përbërja e Komitetit të jetë: dy anëtarë nga pozita, dy anëtarë nga opozita dhe një anëtar i propozohet nga Këshilli i Ministrave Presidentit të Republikës, i cili e dërgon për miratim me dekret në Kuvend. Anëtari i sjellë nga Presidenti dhe i miratuar nga Kuvendi është edhe kryetar i tij.

Në amendamentin e deputetëve të Partisë Republikane propozohet që në përbërjen e Komitetit Shtetëror për Kthimin dhe Kompensimin e Pronave, krahas dy anëtarëve të propozuar nga pozita, dy anëtarëve të propozuar nga opozita dhe një anëtar të propozuar nga Presidenti i Republikës, të ketë edhe një anëtar nga subjektet e shpronësuara.

Amendamenti i paraqitur nga deputetët e Partisë Demokratike është i ngjashëm me atë të paraqitur në projektligj.

Amendamenti i paraqitur nga deputetët e Partisë Demokratike të Re propozon që dy anëtarët e propozuar nga pozita të përfaqësojnë respektivisht partitë PS dhe PSD, dy anëtarët e propozuar nga opozita të përfaqësojnë respektivisht partitë PD dhe PDR, ndërsa anëtari i pestë të propozohet nga Këshilli i Ministrave.

Në përfundim të diskutimit, Kuvendi miratoi me shumicë votash amendamentin e paraqitur nga deputetët socialistë.

- Amendamentet për nenin 6 të projektligjit, në të cilin parashikohet që subjekteve të shpronësuara t’u njihet e drejta e pronësisë dhe t’u kthehen pa kufizim pronat e paluajtshme, me përjashtim të rasteve kur në këtë ligj përcaktohet ndryshe. Amendamentet e paraqitura për këtë nen kanë të bëjnë me kthimin dhe kompensimin e tokës bujqësore, për të cilën disa deputetë ishin të mendimit të kthehet ose të kompensohet deri në 100 ha, disa të tjerë në masën 50 ha. Në përfundim, Kuvendi miratoi kthimin ose kompensimin e tokës bujqësore deri në 60 ha.

- Amendamentet për disa shtesa në nenin 8 të projektligjit. Komisioni i Përhershëm i Ekonomisë, Financave dhe Privatizimit propozoi shtesën e një pike në nenin 8 të projektligjit, e cila parashikon që në rastet e ndërtimeve mbi truall të bëra pas datës 10.8.1991, për të cilat nuk është

(Vijon në faqen 5)

NGA PUNIMET E KUVENDIT PËR PERIUDHËN 1-15 QERSHOR 2004

(Vijon nga faqja 4)

rregjistruar pronësia e truallit, ai që ka në pronësi ndërtesën detyrohet të paguajë vlerën e truallit. Lidhur me konceptin “vlerë e truallit” u shfaqën disa variante: sipas njerit variant trualli do të vlerësohet me vlerën e tregut, ndërsa sipas variantit tjetër vlera e truallit përbëhet nga vlera fillestare e tij në përputhje me ligjin nr.7652, datë 23.12.1992 “Për privatizimin e banesave shtetërore” të shumëzuar me indeksin e rritjes së çmimeve. Komisioni i Përhershëm i Çështjeve Kushtetuese dhe Ligjore u shpreh kundër variantit të dytë të vlerësimit të truallit. Në përfundim, Kuvendi e miratoi amendamentin e Komisionit të Përhershëm të Ekonomisë, Financave dhe Privatizimit, duke mbështetur variantin që vlera e truallit që shteti do t’u kthejë të tretëve të llogaritet në bazë të çmimit të blerjes të shumëzuar me indeksin e rritjes së çmimeve.

- Po në nenin 8 të projektligjit nga Komisioni i Përhershëm i Çështjeve Kushtetuese dhe Ligjore u propozua shtimi i një pike për rastet e ndërtimeve të ligjshme të bëra në truallin e shpronësuar, që janë dhënë me qira ose koncesion. Në këto raste u propozua që subjektit të shpronësuar t’i rinjohet pronësia dhe t’i kalojnë të gjitha të drejtat pronësore që deri me hyrjen në fuqi të këtij ligji i gëzon shteti, me kusht që ai të respektojë kontratën e nënshkruar. Në përputhje me Kodin Civil, pas përfundimit të kontratës, subjekti i shpronësuar vendos vetë për marrëdhëniet e mëtejshme me të tretët. Subjektet e shpronësuara kanë të drejtë të heqin dorë nga prona e tyre kundrejt kompensimit. Komisioni i Përhershëm i Ekonomisë, Financave dhe Privatizimit propozoi një formulim tjetër të këtij amendamenti shtesë, sipas të cilit në rastet e ndërtimeve të ligjshme të bëra në truallin e dhënë nga shteti me qira ose koncesion, pronari i ndërtesës paguan vlerën e truallit mbi të cilin është bërë ndërtesa, sipas çmimeve të tregut. Në përfundim, Kuvendi miratoi propozimin e Komisionit të Përhershëm të Ekonomisë, Financave dhe Privatizimit për këtë çështje.

- Kuvendi diskutoi disa amendamente për shtesën e nenit 8/1 për pronat në zonat turistike. Sipas propozimit të Komisionit të Përhershëm të Çështjeve Kushtetuese dhe Ligjore, subjekteve të shpronësuara në zonat e stimuluar për zhvillimin e turizmit, u rinjohet, kthehet dhe kompensohet prona. Për tokat në këto zona që janë në pronësi të shtetit, organet kompetente të administratës publike ndalohet të lidhin kontrata kompensimi a pronësie me të tretë deri në përfundim të procesit të kthimit dhe kompensimit të pronave. Lidhur me shtesën e këtij neni u diskutuan disa variante dhe në përfundim, Kuvendi nuk e miratoi atë. Kuvendi miratoi edhe një sërë amendamentesh për ndryshime, shtesa e riformulime në nenet e projektligjit.

2. Projektligji “Për një ndryshim në ligjin nr.8701, datë 1.12.2000 “Për lojërat e fatit, kazinotë dhe hipodromet”, nismë e Këshillit të Ministrave, (shqyrtuar në seancë plenare më datë 10 qershor 2004)

Nëpërmjet këtij projektligji synohet të ndryshohet neni 19 i ligjit ekzistues, duke e rritur taksën e lejes për kazinotë nga tridhjetë milionë lekë në njëqind milionë lekë.

Gjatë diskutimit në parim për këtë projektligj, nga deputetët u mbajtën qëndrime të ndryshme.

Një pjesë e deputetëve, veçanërisht ata opozitarë, u shprehën kundër projektligjit, i cili sipas tyre, synon mbylljen e kazinove të vogla dhe monopolizimin e tyre nga disa persona, të cilët i kanë vënë paratë në mënyrë të paligjshme. Për këtë arsye, u shprehën ata, projektligji i hap rrugë korrupsionit, krimin të organizuar dhe pastrimit të parave. Përfaqësuesit e Qeverisë dhe pjesa më e madhe e përfaqësuesve të maxhorancës shpjeguan rëndësinë e këtij projektligji, i cili synon të rrisë të ardhurat e Buxhetit të Shtetit. Ata u shprehën se, në kushtet kur Kuvendi ka miratuar ligjin “Për parandalimin e pastrimit të parave” dhe janë ngritur institucionet përkatëse në zbatim të tij, pasojat negative nga ky projektligj do të jenë minimale. Pas miratimit me shumicë votash të projektligjit në parim, Kuvendi diskutoi disa variante të propozuara nga deputetët për nivelin e taksës së lejes për kazinotë dhe, në përfundim, vendosi që ajo të jetë në masën një miliardë lekë.

3. Raport i Komisionit Hetimor të Kuvendit për Telekomunikacionet (shqyrtuar në seancë plenare më datë 1 qershor 2004). Ky Komision u paraqit në seancë plenare me dy raporte:

-Raporti i shumicës së anëtarëve të Komisionit, i cili arrin në konkluzion që ligji nr.8618, datë 14.6.2000 “Për telekomunikacionet në Republikën e Shqipërisë” është zbatuar në përputhje me politikat e Qeverisë për zhvillimin e telekomunikacioneve, duke synuar veçanërisht zgjerimin e numrit të shërbimeve në zonat rurale, që investimet në sektorin e telekomunikacioneve dhe veçanërisht në Albtelekom janë rritur ndjeshëm, duke rritur të ardhurat e Buxhetit të Shtetit dhe që procedurat e privatizimit në sektorin e telekomunikacioneve janë kryer në përputhje me Strategjinë Kombëtare të Privatizimit.

- Raporti i paraqitur nga minoranca e Komisionit, i cili paraqet një numër të madh shkeljesh ligjore në sektorin e telekomunikacioneve, veçanërisht në procesin e privatizimit të Albtelekomit dhe të AMC-së.

Qëndrimet e mbajtura nga deputetët për raportet e mësipërme dhe për veprimtarinë e Komisionit ishin të grupuara sipas përkatësive politike në ngjashmëri me Raportet e Paraqitura nga ky Komision.

Në përfundim, Kuvendi miratoi një projektvendim, i cili mbështeti Raportin e paraqitur nga maxhoranca e Komisionit.

KALENDAR I

2 JAVOR (21 QERSHOR - 1 KORRIK 2004) I PUNIMEVE TË KUVENDIT

**E Hënë, datë 21.06.2004,
ora 12.00**

-Seancë Plenare

1. Miratimi i Kalendarit 2 javor të punimeve të Kuvendit.
2. Interpelancë me Kryeministrin, kërkuar nga deputeti Dilaver Qesja.
3. Interpelancë me Kryeministrin, kërkuar nga deputeti Uran Metko.
4. Përgjigje e pyetjeve të deputetit Ekrem Spahiu nga Kryeministri.

E Martë, datë 22.06.2004

E Mërkurë, datë 23.06.2004

- Punë në komisione për shqyrtimin e këtyre p/ligjeve:

1. P/Ligji "Për ratifikimin e Marrëveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Këshillit të Ministrave të Bosnjes dhe Hercegovinës, për transportin ajror".

-Komisioni i Ligjeve

-Komisioni i Jashtëm

-Komisioni i Industrisë dhe Telekomunikacionit

2. P/Ligji "Për disa ndryshime në ligjin nr. 9165, datë 23.12.2003 "Për Buxhetin e Shtetit të vitit 2004".

-Komisioni i Ligjeve

-Komisioni i Ekonomisë dhe Financës

-Komisioni i Arsimit dhe Kulturës

-Komisioni i Industrisë

-Komisionet e tjera

3. P/Ligji "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 7748, datë 29.07.1993 "Për statusin e ish të dënuarve dhe të përndjekurve politikë nga sistemi komunist" të ndryshuar me ligjin nr. 7771, datë 7.12.1993" (paraqitur nga një grup deputetësh).

-Komisioni i Ligjeve

-Komisioni i Ekonomisë dhe Financës

-Komisioni i Punës dhe Çështjeve Sociale

-Komisioni i të Drejtave të Njeriut

4. P/Ligji "Për veprimtarinë e sigurimit, të risigurimit dhe ndërmjetësimit të sigurimeve dhe risigurimeve".

-Komisioni i Ligjeve

-Komisioni i Ekonomisë dhe Financës

5. P/Ligji "Për organizimin dhe funksionimin e Autoritetit Mbikqyrës të Sigurimeve".

-Komisioni i Ligjeve

-Komisioni i Ekonomisë dhe Financës

6. P/Ligji "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 7796,

datë 17.2.1994 "Minerar i Shqipërisë".

-Komisioni i Ligjeve

-Komisioni i Industrisë

7. P/Ligji "Për disa ndryshime në ligjin nr. 8553, datë 25.11.1999 "Për Policinë e Shtetit", të ndryshuar.

-Komisioni i Ligjeve

-Komisioni i Rendit

E Enjte, datë 24.06.2004, ora 10.00

-Seancë Plenare

1. P/Ligji "Për ratifikimin e Protokollit Shtesë të Konventës Penale për Korrupsionin".

2. P/Ligji "Për ratifikimin e marrëveshjes plotësuese ndërmjet Qeverisë së Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Shteteve të Bashkuara të Amerikës, të "Marrëveshjes ndërmjet shteteve palë në traktatin e Atlantikut Verior dhe shteteve të tjera pjesëmarrëse në partneritetin për paqe, në lidhje me statusin e forcave të tyre", mbi statusin e forcave të Shteteve të Bashkuara të Amerikës në Republikën e Shqipërisë".

3. P/Ligji "Për disa ndryshime në ligjin nr. 8553, datë (Vijon në faqen 7)

Kalendari dyjavor i punimeve të Kuvendit

25.11.1999 "Për Policinë e Shtetit", të ndryshuar.

4. P/Ligji "Për disa ndryshime në ligjin nr. 9165, datë 23.12.2003 "Për Buxhetin e Shtetit të vitit 2004".
5. P/Ligji "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 7748, datë 29.07.1993 "Për statusin e ish të dënuarve dhe të përndjekurve politikë nga sistemi komunist" të ndryshuar me ligjin nr. 7771, datë 7.12.1993" (paraqitur nga një grup deputetësh).

* * *

E Hënë, datë 28.06.2004, ora 18.00

-Seancë Plenare

1. Interpelancë me Ministrin e Punës dhe Çështjeve Sociale kërkuar nga deputeti Ligoraq Karamelo.
2. Pyetje me Ministrin e Industrisë dhe Energjitikës, kërkuar nga deputeti Rahmi Mehmetllari.
3. Raport i Inspektoriatit të Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive.
- Pyetje dhe diskutime.

E Martë, datë 29.06.2004

E Mërkurë, datë 30.06.2004

- Punë në komisione për shqyrtimin e këtyre p/ligjeve:
1. P/Ligji "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 7843, datë 13.07.1994 "Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme".

-Komisioni i Ligjeve

-Komisioni i Bujqësisë dhe

Ushqimit (e ka

shqyrtuar)

2. P/Ligji "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8025, datë 9.11.1995 "Për mbrojtjen nga rrezatimet jonizuese".

-Komisioni i Ligjeve

-Komisioni i Shëndetësisë

3. P/Ligji "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 7975, datë 26.7.1995 "Për Barnat Narkotike dhe Lëndët Psikotrope".

-Komisioni i Ligjeve

-Komisioni i Shëndetësisë

-Komisioni i Rendit

4. P/Ligji "Për legalizimin e zonave informale".

-Komisioni i Ligjeve

-Komisioni i Industrisë dhe

Telekomunikacionit

-Komisioni i Ekonomisë

dhe Financës

5. P/Ligji "Për legalizimin e ndërtimeve në ngulimet e reja komunitare në qytete" (paraqitur nga një grup deputetësh).

-Komisioni i Ligjeve

-Komisioni i Industrisë dhe

Telekomunikacionit

-Komisioni i Ekonomisë

dhe Financës

6. Dekret nr. 4181, datë 23.03.2004 "Kthimi për shqyrtim edhe njëherë në Kuvend të ligjit nr. 9198, datë 26.02.2004

"Për një shoqëri gjinore të barbartë".

-Komisioni i Ligjeve

-Komisioni i Punës dhe

Çështjeve Sociale

7. P/Ligji "Për punën e Kuvendit në procesin e integritetit të Shqipërisë në Bashkimin Europian" (paraqitur nga deputeti Ilir Zela).

-Komisioni i Jashtëm

-Komisioni i Integritetit

E Enjte, datë 1.07.2004, ora 10.00

-Seancë Plenare

1. P/Ligji "Për ratifikimin e Marrëveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Këshillit të Ministrave të Bosnjes dhe Hercegovinës, për transportin ajror".
2. P/Ligji "Për një shtesë në ligjin nr. 7512, datë 10.8.1991 "Për sanksionimin dhe mbrojtjen e pronës private, të nismës së lirë, të veprimtarive të pavarura dhe privatizimit", të ndryshuar.
3. Dekret nr. 4181, datë 23.03.2004 "Kthimi për shqyrtim edhe njëherë në Kuvend të ligjit nr. 9198, datë 26.02.2004 "Për një shoqëri gjinore të barbartë".

Ftesë e Hapur për Bashkëpunim

(Vijon nga faqja 1)

Albtelekom Sh.A. dhe ARMO Sh.A. Kjo paketë, e cila sipas ligjeve të mësipërme do të miratohet nga Këshilli i Ministrave, është hartuar duke u bazuar në përvojat më të mira ndërkombëtare si dhe në funksion të një privatizimi sa më të suksesshëm me synim realizimin e një procesi transparent, me pjesëmarrje të gjerë dhe konkurrese i cili do të garantojë realizimin e investimeve të domosdoshme për zhvillimin afatgjatë të këtyre shoqërive dhe ekonomisë shqiptare. Nëpërmjet kësaj pakete aktesh nënligjore përcaktohen madhësia e paketës që do t'u ofrohet investitorëve strategjikë, kriteret e vlerësimit të ofertave për privatizimin e dy shoqërive dhe çështje të tjera që lidhen me përdorimin e të ardhurave nga procesi i privatizimit.

Duke vlerësuar rolin tepër të rëndësishëm që këto shoqëri kanë për ekonominë e vendit, Ministria e Ekonomisë, në kuadër të transparencës me publikun, hap këtë proces bashkëpunimi më të gjitha palët e interesuara për të dhënë kontributin e tyre në këtë drejtim.

Nëse ju jeni një organizatë, institucion, shoqatë, pedagog, student, jurist, economist, inxhinier apo

çdo individ, brenda apo jashtë Shqipërisë, që mendoni se mund të jepni kontributin tuaj për përmirësimin ekësaj pakete të rëndësishme aktesh nënligjore, jeni të ftuar për të paraqitur idetë tuaja duke marrë pjesë në këtë bashkëpunim të hapur i cili do të vijojë dhe me një konferencë kombëtare mbi këtë temë, që do të zhvillohet së shpejti nga Ministria e Ekonomisë.

Për të marrë falas një kopje të paketës ju mund të:

Dërgoni një kërkesë me shkrim praën Ministrisë së Ekonomisë.

Kërkoni me telefon ose faks në numrat tel 36 46 33 / 36 46 39 që një kopje t'ju vihet në dispozicion.

Dërgoni një mesazh elektronik në:

privatizim_transparent@miek.gov.al dhe ne do t'ju përgjigjemi duke ju dërguar paketën në formë elektronike.

Kaloni praën Ministrisë së Ekonomisë dhe mund të merrni një kopje të paketës në zyrën nr.14, kati V.

Duke çmuar kontributin tuaj dhe falenderuar për bashkëpunimin, mirëpresim çdo sugjerim, koment apo vërejtje për këtë paketë aktesh nënligjore, të rëndësishme për procesin e privatizimit dhe zhvillimin afatgjatë të ekonomisë shqiptare.

Njoftim

Të nderuar zonja e zotërinj,
Kuvendi i Shqipërisë me datë 30.06.1999 ka miratuar ligjin nr.8503 "Për të drejtën e informimit për dokumentat zyrtare". Ky ligj rregullon të drejtën e informimit për çdo person dhe krijon mundësinë për të marrë informacion mbi dokumentat zyrtare. Ligji përcakton gjithashtu detyrimin e autoriteteve publike për krijimin e lehtësirave dhe ngritjen e strukturave praktike që publiku i gjerë të marrë në mënyrë të saktë, të plotë, të përshtatshme e të shpejtë, informacionin mbi dokumentat zyrtare.

Autoriteti publik vihet në lëvizje me kërkesë të personit të interesuar dhe është i detyruar të krijojë atij të gjitha mundësitë e përcaktuara në këtë ligj, për dhënien e informacionit të kërkuar. Njëkohësisht autoriteti publik që nga momenti i depozitimit të kërkesës është i detyruar, brenda një kohe të përcaktuar në ligj, ta plotësojë atë.

Ligji i jep të drejtën çdo personi të interesuar të ankohet, kur e drejta për informim shkelet nga autoriteti publik. Për të realizuar këtë, ligji përcakton mënyrën dhe rrugët që ky ankim mund të ndiqet nga subjekti i interesuar. Kjo rrugë mund të jetë administrative dhe gjyqësore.

Për të realizuar sa më mirë këtë të drejtë të njohur nga Ligjvënësi Shqiptar, Qendra e Studimeve Parlamentare "QSP" në Tiranë njofton të gjithë të interesuarit si më poshtë;

"Të gjithë individët dhe organizatat të cilët janë viktimë e mohimit të së drejtës për informim, shkeljes së dispozitave të ligjit nr.8503 dt.30.06.1999 "Për të drejtën e informimit për dokumentat zyrtare" do të kenë mundësinë që, pranë QSP, të marrin asistencë ligjore nga një avokat.

Avokati pranë kësaj njësie, do të jetë në dispozicion të subjekteve të sipërpërmendur nga e Hëna në të Enjte ora 15.00 – 17.30

Çdo subjekt i tillë, apo që kërkon informacion më të gjerë mbi këtë të drejtë të saksionuar me ligj, është i mirëpritur pranë QSP."

Denada BRESHANAJ

Koordinatorë Projekti/Project Coordinator

Qendra e Studimeve Parlamentare/Centre for Parliamentary Studies

Rr. Sami Frasheri, Pall. e Aviacionit, nr.3/15

Tirana-Albania Tel/Fax: +355 4 240 214; cps@albaniaonline.net;

www.ascdpd.org